



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DREJTORIA E VLERËSIMIT TË ANKESAVE

Nr. 1967/₄ Prot

Tiranë, më 23 / 12 / 2021

VENDIM

Nr. 60, datë 23 . 12 . 2021

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesja, znj. (në vijim “ankuesi”) ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”) ankesën nr. 1967 Prot., datë 25.11.2021 (vijuar me nr. 1967/3 Prot., datë 22.12.2021), me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”, kundër Autoritetit Publik/Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (në vijim “Autoriteti Publik”).

Ankuesja, në cilësinë e kërkueses, nëpërmjet kërkesës për informacion datë 01.11.2021, ka kërkuar t’i vihet në dispozicion informacioni/dokumentacioni, në lidhje me:

1. Sa do të jetë pagesa totale që do të bëjë Autoriteti Kontraktor, në rastin e kontratës koncesionare/PPP mes Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe kompanisë “Gjoka Konstruksion”, “Për përmirësimin, operimin dhe ndërtimin e “Rrugës së Arbrit”.
2. Sa është vlera që do të investojë kompania “Gjoka Konstruksion” pas rastit të shembjes së Tunelit të Murrizit.
3. A ka patur ndryshim të kontratës mes Autoritetit Kontraktor dhe kompanisë “Gjoka Konstruksion”.

Ndërkohë, nëpërmjet kërkesës datë 11.11.2021, ka kërkuar t'i vihet në dispozicion informacioni/dokumentacioni, në lidhje me:

1. *Vlera e preventivit të zbatimit të projektit "Aletnativa B për Tunelin e Murrizit", pjesë e kontratës koncesionare/PPP mes Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe kompanisë "Gjoka Konstruksion" "Për përmirësimin, operimin dhe ndërtimin e "Rrugës së Arbrit" është 17.5 miliard lekë me TVSH. Kush do të e paguajë koston për vlerën e tunelit, buxheti i shtetit apo kompania koncesionare?*
2. *Nëse është vendosur që koston të ndahen përgjysëm në çfarë vlerash do të paguajë për këtë alternativë buxheti i shtetit?*
3. *A ka patur konsultime me Avokaturën e Shtetit lidhur me pretendimet për pagesën e kostove të Alternativës B të Tunelit të Murrizit?*

Në mungesë të një përgjigje nga ana e Autoritetit Publik, me pretendimin se është cenuar në të drejtën për informim, ankuesja ka paraqitur ankim pranë Komisionerit, duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit.

Zyra e Komisionerit pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa përmbush kriteret formale ligjore, në përputhje me përcaktimet e nenit 24 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" (në vijim "LDI").

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, si hap paraprak përpara marrjes së vendimit, në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", i cili parashikon: "*Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjëndje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur*", Komisioneri, me shkresën nr. 1967/1 prot., datë 02.12.2021 ka kërkuar nga Autoriteti Publik të informohet mbi trajtimin apo procedurën e ndjekur lidhur me kërkesën për informacion si dhe sqarime për disponimin e dokumentacionit të kërkuar.

Në vijim, Autoriteti Publik me e-mail-in datë 09.12.2021, ka informuar ndër të tjera se: "*Në përgjigje të kërkesave datë 01.11.2021 dhe 11.11.2021 dhe të ankesës me nr. 1967/1 prot., datë 02.12.2021, së paraqitur pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, për kontratën e Koncesionit/PPP "Për Përmirësimin, Ndërtimin, Operimin dhe Mirëmbajtjen e Rrugës së Arbrit", sqarojmë se: Së pari, për pyetjen e parë, theksojmë se, pagesa që Autoriteti Kontraktor do të realizojë ndaj palës në Kontratën PPP është sipas modelit financiar dhe do të bëhet në bazë të kësteve të disponueshmërisë, e përcaktuar në Vendimin nr. 180, datë 28.3.2018, të Këshillit të Ministrave me anë të së cilës, është miratuar kontrata e Koncesionit/PPP ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe shoqërisë "Gjoka Konstruksion" sh.a "Për Përmirësimin, Ndërtimin, Operimin dhe Mirëmbajtjen e Rrugës së Arbrit", publikuar në Fletoren Zyrtare me Nr. 50, datë 11.4.2018.*

Së dyti, për sa i përket pyetjeve 2, 3, 4 dhe 5 të kërkesës, sqarojmë se, Kontrata PPP “Për përmirësimin, operimin dhe ndërtimin e Rrugës së Arbrit” nuk ka pësuar ndryshime, nga ajo e miratuar, me VKM-në e sipërcituar.

Së fundi, për pyetjen 6, informojmë se, sipas gërmës a), të pikës 1, të nenit 5 si dhe të pikës 4, të nenit 15, të ligjit nr.10018, datë 13.11.2008 “Për Avokaturën e Shtetit”, të ndryshuar, citohet se: “Avokatura e Shtetit, ofron shërbim këshillimor për veprimtarinë juridike të organeve të administratës shtetërore qendrore dhe të enteve publike, veçanërisht për lidhjen e kontratave, të cilat parashikojnë efekte financiare për shtetin.

Këshillimi paraprak i organit përkatës të administratës publike me Avokaturën e Shtetit është i detyrueshëm për t’u kërkuar, në rastet e hartimit, negocimin nënshkrimin, ndryshimin dhe zgjidhjen e kontratave të koncesionit, të kontratave të partneritetit publik-privat. Për kontrata të tjera publike për kryerje punimesh, furnizim mallrash dhe furnizim shërbimesh, me vlerë mbi kufirin e ulët monetar, të përcaktuar në legjislacionin në fuqi për prokurimet publike.”

Pas përgjigjes së sipërcituar, ankuesja me e-mail-in datë 10.12.2021, i është drejtuar edhe njëherë Autoritetit Publik, me pretendimin se: “Lidhur me kërkesat për informacion të datave 01.11.2021 dhe 11.11.2021 kërkoj të informohem mbi pyetjet që kam bërë, pasi është tërësisht e dukshme që nuk i është kthyer përgjigje pyetjeve që ju kam drejtuar me përjashtim të pyetjes nr 3.

Duke qënë se ju i keni mbledhur të dyja kërkesat dhe renditur në 6 pyetje, më poshtë po jap dhe arsyet se përse nuk i jeni përgjigjur pyetjeve drejtuar institucionit tuaj, konkretisht:

- 1. Sa do të jetë pagesa totale që do të bëjë Autoriteti Kontraktor, në rastin e kontratës koncesionare/PPP mes Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe kompanisë “Gjoka Konstruksion” “Për përmirësimin, operimin dhe ndërtimin e “Rrugës së Arbrit”?*

Në pyetjen e parë kam kërkuar informacion se sa do të jetë pagesa totale, dhe jo nëse do të respektojë kontratën Autoriteti Kontraktor. Kontrata është e publikuar në Fletoren Zyrtare pa Modelin Financiar, pasi e konsideruat “sekret” që nuk pranohej të jepej nga ana e shoqërisë koncesionare për shkak të informacioneve tregtare. Duke respektuar këtë “sekret”, atëherë mund të vini në dispozicion shifrën që do të paguajë shteti, pasi bëhet fjalë për një informacion publik? Sa do të jetë pagesa? 33.6 mld lekë që është në kontratë, 40.3 mld lekë që është në buxhetin e Ministrisë së Financave megjithë TVSH-në, apo do të shtohet në fund edhe pagesa shtesë për Tunelin e Murrizit?

- 2. Sa është vlera që do të investojë kompania “Gjoka Konstruksion” pas rastit të shembjes së Tunelit të Murrizit?*

Në pyetjen e dytë kam kërkuar informacion se sa është vlera shtesë që do të investojë kompania "Gjoka Konstruksion" pas rastit të shembjes së Tunelit të Murrizit. Pra, sa do të kushtojë zgjatja e Tunelit?

3. *A ka patur ndryshim të kontratës mes Autoritetit Kontraktor dhe kompanisë "Gjoka Konstruksion"?*

Në pyetjen e tretë jam dakord me përgjigjen.

4. *Vlera e preventivit të zbatimit të projektit "Aletnativa B për Tunelin e Murrizit", pjesë e kontratës koncesionare/PPP mes Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe kompanisë "Gjoka Konstruksion" "Për përmirësimin, operimin dhe ndërtimin e "Rrugës së Arbrit" është 17.5 miliard lekë me TVSH. Kush do të e paguajë koston për vlerën e tunelit, buxheti i shtetit apo kompania koncesionare?*

Në pyetjen e katërt kam kërkuar informacion se kush do të paguajë kostot shtesë për ndërtimin e Tunelit të ri të Murrizit? Nëse këtë çështje nuk e keni zgjidhur me kompaninë mund të thoni që jeni në diskutime, jo që nuk ka ndryshuar kontrata sepse këtë pyetje e kisha shtruar më sipër.

5. *Nëse është vendosur që kostot të ndahen përgjysëm në çfarë vlerash do të paguajë për këtë alternativë buxheti i shtetit?*

Në pyetjen e pestë po ashtu kam kërkuar të di nëse keni diskutuar për të ndarë kostot me kompaninë apo duhet të mbajë përgjegjësi vetëm njëra nga palët.

6. *A ka patur konsultime me Avokaturën e Shtetit lidhur me pretendimet për pagesën e kostove të Alternativës B të Tunelit të Murrizit?*

Në pyetjen e gjashtë kam pyetur a jeni konsultuar për këtë çështje me Avokaturën e Shtetit dhe jo se çfarë parashikon ligji.

Në mungesë të një reagimi nga Autoriteti Publik, ankuesja ka vijuar me ankimin e regjistruar me nr. 1967/3 Prot., datë 22.12.2021, duke kërkuar detyrimin e Autoritetit Publik për të vënë në dispozicion informacionin lidhur me pikat 1 dhe 2 të kërkesës për informacion datë 01.11.2021 (pasi e konsideron të përmbushur pikën e 3-të), si edhe pikat 1, 2 dhe 3 të kërkesës për informacion datë 11.11.2021.

Për sa më sipër, nga verifikimi i dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ, Komisioneri, konstaton se objekti i kërkesave ka të bëjë me një kontratë koncesionare, palë e së cilës është edhe Autoriteti Publik kundër të cilit është drejtuar kjo ankesë.

Në nenin 2, të LDI parashikohet se: "Autoritet publik" është çdo organ administrativ i parashikuar në legjislacionin në fuqi për procedurat administrative, organet ligjvënëse, gjyqësore dhe ato të prokurorisë së çdo niveli, organet e njësisve të qeverisjes vendore të çdo niveli, organet shtetërore dhe entet publike, të krijuara me Kushtetutë ose me ligj". Në kuptim të këtij parashikimi, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë është Autoritet Publik dhe subjekt i LDI, për rrjedhojë detyrohet për zbatimin e tij, duke garantuar njohjen e publikut me informacion në kuadër të transparencës.

Gjatë hetimit administrativ, Autoriteti Publik, nuk provoi në asnjë moment se është në kushtet e nenit 17 të LDI për mosvënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar, duke qenë se është ky nen, i cili parashikon mundësinë e kufizimit të të drejtës për informim, shkaqet dhe arsyet që mund të çojnë një autoritet publik për të kufizuar të drejtën për informim, si dhe rastet përjashtimore nga ky rregullim.

Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se, informacioni i kërkuar në kërkesat për informacion datë 01.11.2021 dhe 11.11.2021, në parim përmbush kriteret e pikës 2, të nenit 2, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, ku *“informacion publik” konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik”*.

Autoriteti Publik duhet të vendosë në dispozicion të kërkuarit çdo informacion/dokument, i cili është prodhuar ose mbahet nga ky i fundit në formën e zotëruar, duke mbajtur në konsideratë edhe pikën 6 të nenit 17 të ligjit të sipërcituar.

Theksojmë se e drejta për t’u informuar është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

Në pikën 3 të nenit 3 të LDI parashikohet se, *“Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit original ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit”*.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 10 dhe 12 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Pranimin e ankesës nr. 1967 Prot., datë 25.11.2021 të znj. _____, kundër Autoritetit Publik “Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë”, me objekt *“Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”*.
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik, për vënien në dispozicion të informacionit sipas kërkesave për informacion datë 01.11.2021 dhe 11.11.2021, në lidhje me:
 - 1- *Sa do të jetë pagesa totale që do të bëjë Autoriteti Kontraktor, në rastin e kontratës koncesionare/PPP mes Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe kompanisë “Gjoka Konstruksion” “Për përmirësimin, operimin dhe ndërtimin e “Rrugës së Arbrit”*.
 - 2- *Sa është vlera që do të investojë kompania “Gjoka Konstruksion” pas rastit të shembjes së Tunelit të Murrizit.*

- 3- Vlera e preventivit të zbatimit të projektit “Aletnativa B për Tunelin e Murrizit”, pjesë e kontratëskoncesionare/PPP mes Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe kompanisë “GjokaKonstruksion” “Për përmirësimin, operimin dhe ndërtimin e “Rrugës së Arbrit” është 17.5 miliard lekë me TVSH. Kush do të e paguajë koston për vlerën e tunelit, buxheti i shtetit apo kompania koncesionare?
- 4- Nëse është vendosur që kostot të ndahen përgjysëm në çfarë vlerash do të paguajë për këtë alternativë buxheti i shtetit?
- 5- A ka patur konsultime me Avokaturën e Shtetit lidhur me pretendimet për pagesën e kostove të Alternativës B të Tunelit të Murrizit, duke respektuar kufizimet, në përputhje me pikën 6 të nenit 17 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, brenda datës 31.12.2021.
3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas nenit 25 të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
4. Ky vendim u shpall sot në datë 23.12.2021.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

Besnik Dervishi

